



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0041977/25 dt. 17.07.2025

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **premtën** më dt. **25.07.2025**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa
Seanca e 43

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025

Mbledhja mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr. 02-060/01-0033857-1/25 dt. 19.06.2025
Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 42-të

Koha: 19.06.2025 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri
Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Drejtorët e Drejtorive
Mungoi: Shkurta Shosholli Musa

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 42-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Rendi i ditës u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit para se ta hapë diskutimin lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 theksoi se dje gjatë ditës ju ka bashkëngjitë edhe procesverballi i dëgjimit publik që u mbajtë për Kornizën Afatmesme Buxhetore, fillimisht po ia kalojmë fjalën drejtoreshës së DBF-së e pastaj po hapim për diskutim.

Igballë Islami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ministria e Financave ka procesuar Qarkoren Buxhetore 2026-01. Bazuar në totalin e financimit që na është dhënë, kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore, duke pasur gjithmonë parasysh obligimet kontraktuale dhe të tjera financiare që i ka Komuna e Mitrovicës. Në mbledhjen e kaluar të Komitetit për Politikë dhe Financa kemi shqyrtuar së bashku Draftin Buxhetor. Kemi diskutuar grantet që na janë ndarë nga Komisioni për Ndarjen e Granteve në nivel të Republikës së Kosovës. Gjatë javës së kaluar është mbajtur edhe dëgjimi publik me qytetarët lidhur me draftin e parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore, në koordinim me Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e drejtorive. Duke pasur parasysh se kemi lëshuar deklaratat e disponueshmërisë për projektet kapitale, të cilat bazohen edhe në parashikimet për dy vitet e ardhshme, kemi vlerësuar se duhet bërë një ndryshim në draftin e parë. Ky ndryshim lidhet me kategorinë e pagave, duke parë trendin e rritjes së pagave nga niveli qendror dhe faktin se shpenzimet që po bart Ligji për rritjen e koeficientit (në vlerën 110 €) nuk mbulohen. Kjo padyshim ka ndikuar në komunën e Mitrovicës dhe në kategorinë e pagave. Ne kemi vendosur që kategoritë ekonomike dhe kapitale të mbeten si në buxhetin aktual, domethënë në vlerë 7.4 milionë €, ndërsa diferencën prej 2.1 milionë € e kemi dedikuar plotësisht kategorisë së pagave. Jemi të vetëdijshëm që Komuna e Mitrovicës ka nevojë për rritje edhe në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në kategorinë subvencione, por kemi qenë të limituar dhe detyruar që të mbulojmë pagat për vitin aktual 2026 dhe të mos shkaktojmë probleme në rekrutimin apo ekzekutimin e pagave për punonjësit e administratës së komunës së Mitrovicës. Ky është ndryshimi që po ua pasqyroj edhe përmes tabelës: kategoritë ekonomike vazhdojnë të mbesin të njëjta siç janë në vitin aktual, ndërsa rritja prej 2.1 milionë € i dedikohet plotësisht kategorisë së pagave.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Dëshiroj t'i falënderoj anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa, si dhe të gjithë të pranishmit. Singerisht, ju falënderoj për një punë jashtëzakonisht të vlefshme gjatë gjithë këtij mandati. Nuk kam ndonjë lutje tjetër përveç që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, po ashtu edhe të Asamblesë, ta aprovojnë buxhetin e komunës së Mitrovicës për vitin e ardhshëm. Pavarësisht që është vit zgjedhor, ky buxhet do të mbetet pjesë e mandatit të ardhshëm për t'u ekzekutuar. Nëse dikush që e udhëheq komunën në të ardhmen vlerëson se duhet të bëhen ndryshime, mund t'i bëjë ato në përputhje me ligjet. Por nuk është mirë që Komuna e Mitrovicës të hyjë në vitin zgjedhor pa buxhet të aprovuar, pa buxhet për vitin fiskal që vjen. Po i shohim disa komuna që nuk e kanë aprovuar buxhetin në kohë dhe tash përballen me mungesë të Kuvendit, e kjo po sjell vështirësi të shumta, përfshirë zhvillimet që nuk po bëhen në përputhje me ligjet. Nuk dua të paragjykoj, por hipotetikisht mund të ndodhin probleme. Prandaj, këtë lutje e kam: ta nisim mirë me Kornizën Buxhetore për Mitrovicën, duke pasur parasysh gjendjen aktuale. Buxheti i ri dhe financimi nga niveli qendror kanë ardhur pas regjistrimit të ri të popullsisë. Kjo do të thotë që nuk na ndahet më buxheti si komunë me 72 mijë banorë, por si komunë me 64 mijë banorë, dhe kjo ka ndikuar në financimin lokal nga niveli qendror. Rritja që kemi është simbolike dhe shkon kryesisht për pagat, për shkak edhe të rritjes së tyre. Në të kaluarën, rritja e pagave ka qenë barrë e nivelit qendror, sepse ai ka financuar plotësisht masën e pagave, ndërsa kategoritë tjera kanë mbetur në nivele më të larta. Sipas trendit që po ndjek, pres që këtë vit të kemi një përmbushje, ndoshta edhe tejkalim të planit të të hyrave, dhe sigurisht do të ketë edhe bartje të të hyrave nga ky vit në vitin e ardhshëm. Gjendja financiare është e konsoliduar. Nëse dikush thotë se Komuna e Mitrovicës nuk ka borxh, po, ka borxh, por vetëm nëse nuk i ka plotësuar kushtet ligjore. Çdo faturë që plotëson kushtet ligjore për t'u ekzekutuar, ekzekutohet pa vonesë. Ende vazhdojnë të vijnë urdhëra përmbarimorë, të cilëve po mundohem t'u besoj që janë në fazën përfundimtare. Nuk di se kur do të përfundojnë plotësisht, por edhe pse vazhdojnë, kemi arritur t'i

akomodojmë. Çfarë kanë ndikuar urdhërat përmbarrimore? Kanë ndikuar që disa projekte të mos fillojnë, sepse nuk mund të fillosh projektin nëse nuk ke financim, ose nëse dikush ka marrë para përmes vendimit përmbarrimor. Kjo ka ndikuar kryesisht në kategorinë kapitale. Është një situatë goxha absurde që komuna paguan dëm pa fajin e vet, sepse kontratat kolektive nuk i ka nënshkruar komuna, ndërsa kur ekzekutohen këto pagesa, thuhet se ka keqklasifikim në buxhet. Por si mund të ketë keqklasifikim kur raporti i auditimit i konsideron këto pagesa? Përmbarrimi ekzekutohet pa marrë parasysh organizatën buxhetore; pyetja është vetëm nga do të merren mjetet, nëse nuk deklarohesh brenda një afati të caktuar. Prandaj ju lus që të aprovohet korniza dhe të procedohet në Kuvend. Kufijtë janë këta dhe nuk mund t'i ndryshojmë, pasi Ministria e Financave nuk i pranon shtyrjet e kufijve buxhetorë. Brenda këtyre kufijve mund të diskutojmë për projektet specifike gjatë seancës për buxhet. Unë prapë them se për mua është e sigurt që korniza do të kalojë. Për mua, që jam në përmbysje të mandatit tim si Kryetar i Komunës, ka qenë nder i veçantë të punoj me ju. Diskutimet kanë qenë konstruktive, me rekomandime dhe propozime të mira, edhe kritikën kur kanë qenë, kanë qenë profesionale dhe në interes të përmirësimit të punës sonë. Prandaj, shpreh mirënjohjen time për ju pa dallim. Ju lus që ta merrni në konsideratë që kur të vijë buxheti në seancën e shtatorit (e di që është kohë fushate dhe do të ketë tensione), na si njerëz me përvojë që duam të shërbejmë qytetit tonë, është mirë të mbajmë parasysh që shumica ka përgjegjësi për të bërë shumicën dhe për të votuar, por gjithashtu edhe propozimet e opozitës duhet të merren në konsideratë. Për të përmbysur, uroj që të kemi konstituimin e Kuvendit, edhe pse nuk e di si do të shkojë situata. Nëse vazhdon kjo situatë deri në pranverën e vitit të ardhshëm pa konstituim të Kuvendit, bazuar në përvojën e mëparshme, siguroj që vendi në muajin mars do të përballë me vështirësi të jashtëzakonshme. Buxheti shpenzohet edhe në dy muajt e parë të vitit të ardhshëm, por me muajin e tretë është e domosdoshme të ketë vendim të Kuvendit për zgjatjen e shfrytëzimit të ndarjeve buxhetore, në të kundërt paralizohet pagesa e çdo obligimi, përfshirë paga, pensione dhe obligime të tjera. Megjithatë, para nesh ka kohë dhe unë shpresoj që të gjendet zgjidhje dhe të mos arrijmë në atë situatë. Nuk dua ta besoj që do të ndodhë, por nëse ndodh, ju po ju them me përgjegjësi që është qershor dhe situata do të jetë shumë e vështirë në mars. Prandaj, faleminderit shumë juve, kryesueses dhe të gjithëve. Ju lus që ta votoni Kornizën Buxhetore dhe ta procedojmë në Kuvend. E di që niveli qendror e ka këtë dokument me shumë informues për Kuvendin, nuk është votuar gjithmonë, por është një orientim për buxhetin e tri viteve të ardhshme. Në Kuvend duket se do të votohet, kështu që nuk e shoh si problem këtë çështje.

Hysen Muzliukaj: Përshëndetje të gjithë të pranishëmve. Desha të ndërlihem me materialin që na e keni sjellë sot, si dhe raportin e dëgjimit publik që na e keni sjellë dje, ka shpërputhje me atë që u tha në dëgjimin publik, sot kemi një raport tjetër. Proceduralisht, a jemi në rregull sepse kanë lu shifrat, qytetarët kanë pasur disa të dhëna, ndërsa në raportin që kemi tani, shifrat janë tjera. A është kjo në përputhje me procedurat? Unë e di që do të më thoni po, unë do të doja që të ishte një pasqyrë më e saktë dhe më e qartë, edhe për shkak se është fundi i mandatit, por edhe për korrektësi ndaj vetes, ndaj jush edhe me procedurat. Në këtë rast, do të ishte mirë nëse Sekretaria ose dikush tjetër do të na informonte nëse dëgjimi publik është zhvilluar sipas rregullave dhe nëse ka pasur ndonjë ndryshim në materialet e dorëzuara. Sot kemi paraqitjen e kornizës përfundimtare, e di që është në fazën finale, por pa ndryshime të mëdha në tekst.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Z. Muzliukaj, po, ndryshime kanë ndodhur, por dua të theksoj që këto ndryshime kanë ndodhur në dobi të atyre që kanë marrë pjesë në dëgjimin publik. Dëgjimi publik është mbajtur me një masë më të madhe pagash, ndërsa tani një pjesë e kësaj mase është zhvendosur në kategorinë e kapitaleve, çka nënkupton që realisht mund të realizohen më shumë projekte. Ne kemi një numër të konsiderueshëm të pozitave të aprovuara por të paplotësuar. Gjatë asnjë faze të vitit apo mandatit nuk e kemi tejkaluar numrin e lejuar të punësimeve. Thjesht nuk kemi arritur t'i plotësojmë ato vende pune, disa prej tyre ishin të domosdoshme, por për shkak të kufizimeve nuk kemi mundur t'i mbulojmë. Po, janë rritur pagat, por kjo rritje nuk është shoqëruar me rritjen e masës buxhetore për pagat, dhe kjo na ka futur në një deficit. Aktualisht, në

nivel organizativ buxhetor, kemi ndoshta rreth 170–200 pozita të paplotësuara. Kemi marrë edhe shkresë zyrtare nga Thesari, ku kërkohet që të kemi kujdes me rekrutimet për të ruajtur stabilitetin buxhetor. Ne e respektojmë këtë shkresë, sepse është një dokument institucional. Lëvizja që është bërë nga pagat drejt kapitaleve është në përputhje me prioritetet. Po të kishte ndodhur e kundërta, pra zhvendosja nga kapitale në paga, qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjimin publik do t'u thuhej sot se kanë pas më shumë projekte të planifikuara, e tash më pak. Por në këtë rast, për projektet që kemi diskutuar, jo vetëm që janë aty, por janë shtuar edhe disa. Dhe kjo, në fakt, është pozitive. Dëgjimet publike janë bërë, janë publikuar edhe gjatë fazës së draftimit dhe zhvillimit të buxhetit. Dhe mendoj që jemi në një fazë ku flasim në nivel të kategorive ekonomike. Për projektet specifike – nëse do të jetë një rrugë, një shkollë apo një çerdhe – kjo do të përcaktohet më vonë brenda kategorisë kapitale, sepse ende nuk është specifikuar në detaje. Ajo që po i kërkoj Drejtorisë, gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin 2026 dhe për vitet vijuese, është që fillimisht të merren parasysh obligimet ligjore dhe kontratat ekzistuese. Kjo nënkupton që të buxhetohet saktësisht masa e pagave dhe të mbulohen të gjitha kontratat në fuqi. Ka pas raste që kontratat ekzistojnë, por nuk janë buxhetuar mjaftueshëm, dhe kjo krijon hapësirë për projekte të reja që nuk mund të realizohen realisht. Kërkesa ime është që të bëhet përpjekje që mandati i ardhshëm të fillojë me një buxhet të konsoliduar, pa lënë prapa obligime financiare apo kontraktuale. Jo të gjitha kontratat përfundojnë më 31 dhjetor të këtij viti, por ato që janë aktive duhet të buxhetohen 100%. Pastaj, çfarë mbetet si hapësirë, mund të përdoret për projekte të reja. Z. Muzliukaj, besoj që edhe në raport me dëgjimin publik dhe procesverbalin, kjo situatë nuk vendos në pozitë të pafavorshme ata që kanë marrë pjesë në dëgjimin publik. Përkundrazi, ato që janë diskutuar janë të përfshira dhe është shtuar edhe diçka më shumë – dhe kjo është pozitive. Pozitat e paplotësuara të aprovuara nuk kanë gjasa reale të plotësohen në gjashtëmujorin e parë të vitit të ardhshëm, për shkak të procedurave të gjata dhe shpeshherë të ndërlikuara të rekrutimit. Edhe nëse buxhetohen nga janari, realisht pagat fillojnë të merren diku në gjashtëmujorin e dytë. Kështu që nuk e shoh si problematikë. Nëse ka ndonjë paqartësi ose nevojë për sqarim shtesë, unë gjithmonë jam i gatshëm. Ka pasur raste kur i kemi shtyrë pikat edhe për ndonjë mbledhje tjetër, dhe nuk ka pas asnjë problem, sepse kufijtë buxhetorë nuk janë cenuar. Në fund të fundit, qytetarët nuk e matin punën tonë me masa pagash. Ata interesohen për projekte konkrete në terren – rrugë, çerdhe, shkolla, investime kapitale që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre.

Xhylljeta Imeri: Dëshiroj të ngre një çështje që për mua është e rëndësishme. Më intereson të di se sa është dallimi në numrin e stafit mes vitit 2025 dhe 2026. Gjithashtu, më duhet të theksoj se për mua është e papranueshme që për tri vitet e ardhshme të jetë planifikuar i njëjti numër i stafit. E kuptoj që për vitin 2027 dhe 2028 kjo mund të jetë më shumë formale, por nëse kemi për synim hapjen e çerdheve të reja, atëherë automatikisht duhet të parashikojmë edhe rritje të numrit të të punësuarve. Po ashtu, nëse kemi plan të angazhojmë psikologë, asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta apo të plotësojmë pozita që kërkohen me hapjen e institucioneve të reja për fëmijët, atëherë besoj që numri i stafit duhet të pasqyrojë këto zhvillime dhe të dallojë nga viti në vit.

Igballe Islami: Unë qëllimisht nuk u lëshova te detajet në qarkoren buxhetore, sepse në mbledhjen e kaluar të KPF-së e kemi shqyrtuar bashkërisht qarkoren, ju kemi njoftuar edhe bashkërisht e kemi diskutuar që edhe grantet janë ndarë sipas formulës së re, domethënë sipas regjistrimit të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe unë po pajtohem plotësisht me juve që neve na duhet staf më i madh, pikërisht tek stafi arsimor mirëpo, edhe këtë ua kemi sqaruar gjatë mbledhjes së kaluar të Komitetit për Politikë dhe Financa, ashtu siç ndahet buxheti për kokë banori, ashtu ndahet edhe stafi pikërisht arsimor bazuar në nxënësit të cilët e vijnë mësimin në territorin e Komunës së Mitrovicës. Rrjedhimisht, neve na është ndarë stafi, sepse në qarkoren e parë nuk specifikohet stafi tjetër vetëm ai arsimor, ndërsa është në të njëjtën vlerë, në të njëjtin total siç është në vitin aktual. Ndërsa stafin përfundimisht e dimë sa është, domethënë sa është totali i stafit me qarkoren e dytë, e cila është gjatë muajit gusht, domethënë atëherë kur vjen qarkorja e dytë 2026/02. Kemi nevojë për staf shtesë. Kemi nevojë edhe për shtim të stafit për fëmijët me

asistencë dhe me nevoja të veçanta, mirëpo krejt kjo bazohet domethënë qarkoren buxhetore, ndërsa është Ministria e Financave ajo e cila e përcakton edhe stafin edhe gjitha grantet tjera, Korniza Afatmesme Buxhetore është propozim të cilën ne e dërgojmë në Ministrinë e Financave, ndërsa prapë janë zyrtarët kompetentë, domethënë përgjegjësia mbetet në Ministrinë e Financave dhe lehtësisht këta kufijtë buxhetorë mundën me u ndërruar në kategori ekonomike, njëjtë si presim me pas edhe me stafin. Përfundimisht, sa e kemi stafin të buxhetuar për vitin 2026, bazuar në qarkoren, kështu që gjithçka varet nga ministria dhe nga regjistrimi i fëmijëve në territorin e komunës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:30 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesja e Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Vesa BROJA



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	15-07-2025
REFERENC-Ë:	02-400/01-0041377/25
PËR/ZA/TO:	z. Vesa BROJA – Kryesuese e Kuvendit Komunal
KOPJE :	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bedri HAMZA – Kryetar i Komunës së Mitrovicës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Financiar Janar - Qershor 2025



Të nderuar/a,

Kryetari i Komunës në kuadër të përpjekjeve për transparencë, respektim të legjislacionit dhe bashkëpunim me Anëtarët e Kuvendit ju prezanton:

**RAPORTIN FINANCIAR TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR
PERIUDHËN JANAR – QERSHOR TË VITIT 2025**

Si gjithmonë ne do të jemi të gatshëm në bashkëpunim për të ofruar edhe sqarime shtesë në rast se kërkohet.

Shënim: Zyrtarët e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa mbajnë të drejtën e plotësimit ndryshimit të këtij raporti për rastet e ndryshimit të gjendjes në SIMFK.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



RAPORT FINANCIAR

PËR REALIZIMIN E BUXHETIT KOMUNAL

JANAR – QERSHOR

2025

.....

<https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/>



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
1. TË HYRAT VETANAKE	4
1.1 Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale.....	4
1.2 Krahاسimi i inkasimit të të Hyrave Vetanake me Planifikimin sipas Drejtorive	4
2. BUXHETI DHE SHPENZIMET	5
2.1 Shpalosja e Buxhetit	5
2.2 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave.....	6
2.3 Paga dhe shtesa	7
2.4 Mallra dhe shërbime	7
2.5 Shpenzime Komunale	8
2.6 Subvencione dhe transfere	9
2.7 Investime Kapitale	9
3. Shpalosja e shpenzimeve sipas programeve/nëprogrameve në kategori ekonomike.....	9
3.1 Paraqitja grafike e shpenzimeve të buxhetit sipas programeve/nënprogrameve buxhetore	14
3.2 Shpalosja e shpenzimeve në Investime Kapitale	15
4. OBLIGIMET E PAPAGUARA (BORXHET)	19
5. LËNDËT E EKZEKUTUARA NGA MINISTRIA E FINANCAVE – DEPARTAMENTI I THESARIT	19



HYRJE

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit - LMFP-së¹ neni 45 paragrafi 4, kryetari i komunës është i obliguar të përgatisë dhe t'i dorëzojë kuvendit raporte periodike dhe vjetore financiare, të cilat mbulojnë vitin fiskal. Pastaj në këtë kontekst raporti duhet të publikohet nga kryetari i komunës në webfaqen zyrtare të komunës dhe një kopje ti dorëzohet Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere pas përfundimit të çdo tre mujori.

Qëllimi i këtij Raporti është që të njoftoi Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediat (elektronike dhe të shkruara) si dhe qytetarët e komunës së Mitrovicës për ekzekutim të buxhetit komunal.

Buxheti fillestar i Komunës për vitin 2025 nënkupton LIGJI NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN.

Sipas mendimit tonë, raporti financiar paraqet një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për periudhen raportuese të institucionit Komuna e Mitrovicës

Si gjithmonë, ne e mirëpresim komentet dhe sygjërimet tuaja të cilat do kontribonin pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së raportimeve periodike në të ardhmën.

¹ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë



1. TË HYRAT VETANAKE

1.1 Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale

- Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2025 është në shumën prej 3,615,495.00 Euro sipas LIGJIT NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025.

Shenim: Dënimet në trafik, Gjobat e Gjykatave dhe të hyrat nga Agjensioni i Pyjeve nuk inkasohen direkt nga Komuna dhe institucionet nën menaxhimin e saj.

1.2 Krahassimi i inkasimit të të Hyrave Vetanake me Planifikimin sipas Drejtorive

	Drejtoria	Realizimi - 2025	Plani - 2025	% inkasimit të Planit Vjetor
1	Administrata	34,336.01	95,000.00	36.14%
2	Integrimet Evropiane	-	40,000.00	0.00%
3	Inspeksioni	9,967.50	13,000.00	76.67%
4	Buxhet dhe Financa	743,300.22	1,278,882.00	58.12%
5	Bujqësia	-	7,070.00	0.00%
6	Pylltari dhe Inspeksion	28,587.31	79,000.00	36.19%
7	Zhvillimi Ekonomik	9,555.00	27,000.00	35.39%
8	Gjeodezi dhe Kadastër	112,677.45	335,000.00	33.64%
9	Urbanizmi	716,762.04	1,531,643.00	46.80%
10	Sherbimet Sociale	1,830.00	3,800.00	48.16%
11	Sherbimet Kulturore	360.00	2,100.00	17.14%
12	Sherbimet e Kujdesit Primar	13,698.50	40,000.00	34.25%
13	Çerdhja e Fëmijëve	54,828.00	100,000.00	54.83%
14	SHMT Arkitekt Sinani	22,560.00	35,000.00	64.46%
15	SHME Hasan Prishtina	19,231.00	25,000.00	76.92%
16	SHMM Xheladin Deda	-	3,000.00	0.00%
17	Denimet e Policise	192,706.00		
18	Gjobat nga Gjykatat	54,495.00		
19	Agjensioni i Pyjeve	382.10		
	TOTALI	2,015,276.13	3,615,495.00	55.74%

Tabela 1



2. BUXHETI DHE SHPENZIMET

2.1 Shpalosja e Buxhetit

- Buxheti fillestar i aprovuar në Kuvend Komunal është në shumën prej 30,240,512.00 Euro. Grantet Qeveritare marrin pjesë me 26,625,017.00 € dhe Të Hyrat Vetanake janë në shumën prej 3,615,495.00 €.
- Donacione e Brendshme dhe participimet e qytetarëve duke përfshirë edhe ato të bartura nga viti 2024 dhe vitet paraprake janë në shumën prej 65,748.78 Euro:
 - 13,152.94 € - Mallra dhe Shërbime
 - 29,773.45.45 € - Subvencione dhe Transfere
 - 22,822.39 € - Investime Kapitale.
- Donacione e Jashtme duke përfshirë edhe ato të bartura nga viti 2024 dhe vitet paraprake janë në shumën 29,911.78 Euro.
 - 13,331.60 € - Paga dhe Shtesa
 - 8,998.79 € - Mallra dhe Shërbime
 - 7,581.39 € - Investime Kapitale.
- Raporti është bazuar në ndarjet e Ligjit 08/L-332 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe të raporteve të gjeneruara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK).



2.2 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave

	2025			2024		
	Realizimi	Buxheti Aktual	Index %	Realizimi	Buxheti Aktual	Index %
BURIMET E FONDEVE - PRANIMET						
Granti qeveritar	13,693,499.35	27,335,350.67	50%	13,320,255.77	25,120,335.89	53%
Të hyrat vetanake	1,139,723.65	3,615,495.00	32%	793,026.34	3,288,173.99	24%
Të hyrat vetanake 22	-	-	#DIV/0!	59,714.65	1,179,238.22	5%
Grantet e përcaktuara të donatorëve	6,623.98	95,660.56	7%	8,279.63	115,688.90	7%
Gjithsej	14,839,846.98	31,046,506.23	48%	14,181,276.39	29,703,437.00	48%
KATEGORITE EKONOMIKE - PAGESAT						
Paga dhe rroga	8,055,858.24	16,844,680.27	48%	10,171,365.48	15,885,639.82	64%
Mallra dhe shërbime	1,980,659.09	4,842,151.73	41%	2,177,654.60	4,208,549.59	52%
Shpenzime komunale	269,587.67	600,000.00	45%	237,587.63	616,801.17	39%
Transfere dhe subvencione	584,585.83	1,238,923.45	47%	320,907.60	1,446,256.16	22%
Shpenzime kapitale	3,896,989.33	7,520,750.78	52%	1,273,761.08	7,546,190.26	17%
Gjithsej	14,787,680.16	31,046,506.23	48%	14,181,276.39	29,703,437.00	48%

Tabela 2

Shenim: Të dhënat e prezantuara në tabelën nr.2 janë të dhëna të gjeneruara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) dhe perfshijne te gjitha Fondet Burimore te Organizatës Buxhetore **642 - Komuna e Mitrovicës**.



2.3 Paga dhe shtesa

Pershkrimi	Shuma €
11111 - PAGA NETO	6,340,345.64
11121 - TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	412,852.22
11131 - KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	382,984.80
11151 - SINDIKATAT	17,569.60
11152 - ODAT PROFESIONALE	7,025.39
11211 - PËRVOJA E PUNËS	341,446.62
11311 - KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	382,984.80
11411 - SHTESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT	20,482.16
11415 - SHTESA PËR PUNËN PA ORAR TË PARACAKTUAR	1,937.37
11416 - SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS	2,546.17
11418 - SHTESA PËR NËPUNËSEN/IN E SISTEMIT SHËNDETËSOR	10,489.18
11431 - KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	123,379.81
11432 - FUNKSIONET SHITESË	1,888.66
11611 - SHTESAT TRANZITORE	5,561.47
11900 - VENDIMET GJYQËSORE	4,364.35
Paga dhe shtesa	8,055,858.24

Tabela 3

2.4 Mallra dhe sherbime

Pershkrimi	Shuma €
13140 - TRANSPORTI PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	598.99
13141 - PARA XHEPI/MËDITJET PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	2,464.40
13310 - INTERNETI	2,120.74
13320 - TELEFONIA MOBILE	2,837.25
13330 - SHËRBIMET POSTARE	40.20
13410 - SHËRBIMET E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT	16,383.00
13420 - SHËRBIMET E PËRFAQËSIMIT PËR AVOKATURË	8,496.00
13430 - SHËRBIMET E NDRYSHME SHËNDETËSORE	16,140.00
13445 - SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	3,940.00
13450 - SHËRBIMET E SHTYPJES/PRINTIMIT	12,758.69
13460 - SHËRBIMET KONTRAKTUESE TË TJERA	300,290.25
13470 - SHËRBIMET TEKNIKE	13,712.59
13475 - SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE	65,964.02
13480 - SHPENZIMET E ANËTARËSIMIT	17,650.00
13501 - MOBILJET	78,386.43
13503 - KOMPJUTERËT	997.99
13504 - PAJISJET E TJERA TË TEKNOL.INFORMATIVE DHE TË KOMUNIKIMIT	4,085.74
13506 - PAJISJET SPECIALISTIKE MJEKËSORE	3,489.00



13509 - PAJISJET E TJERA	41,637.03
13511 - PAJISJET SPORTIVE	696.40
13610 - FURNIZIMET PËR ZYRË	21,293.64
13611 - FURNIZIMI ME DOKUMENTE BLLANKO	19,235.90
13616 - FURNIZIMI ME ARTIKUJ BUJQËSOR	2,022.10
13620 - FURNIZIMI ME USHQIM DHE PIJE (JO DREKA ZYRTARE)	19,091.01
13630 - FURNIZIMET MJEKËSORE	191,549.33
13640 - FURNIZIMET E PASTRIMIT	53,313.08
13650 - FURNIZIMI ME VESHMBATHJE	1,193.00
13660 - AKOMODIMI PËR MIKPITJE TË DELEGACIONEVE TË JASHTME	575.00
13720 - NAFTA PËR NGROHJE QENDRORE	76,102.64
13760 - DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE	5,594.50
13780 - DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	28,460.15
13810 - AVANCË (PARADHËNIA) PËR PARA TË IMËTA	200.00
13950 - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	4,150.88
14010 - MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	7,767.60
14020 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE TË BANIMIT	3,580.00
14022 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE	10,919.00
14023 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE	40,648.30
14024 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE SHËNDETËSORE	28,127.52
14026 - MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SPORTIVE	940.00
14032 - MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE	272,582.95
14040 - MIRËMBAJTJA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE TË KOMUNIKIMIT	228.50
14050 - MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE	50,598.72
14060 - MIRËMBAJTJA RUTINORE	267,799.42
14110 - QIRAJA PËR NDËRTESA	7,500.00
14120 - QIRAJA PËR TOKË	1,342.40
14310 - KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BREND A VENDIT	83,806.52
14410 - VENDIMET GJYQËSORE	189,348.21
Paga dhe shtesa	1,980,659.09

Tabela 4

2.5 Shpenzime Komunale

Pershkrimi	Shuma €
13210 - ENERGJIA ELEKTRIKE	214,697.27
13220 - SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	31,738.01
13230 - MBETURINAT	15,032.04
13250 - TELEFONIA FIKSE	8,120.35
Shpenzime komunale	269,587.67

Tabela 5



2.6 Subvencione dhe transfere

Pershkrimi	Shuma €
22115 - TRANSFERET PËR ENTITETET JOPUBLIKE	143,300.45
22202 - TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	347,325.38
22298 - PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT	93,960.00
Subvencione dhe transfere	584,585.83

Tabela 6

2.7 Investime Kapitale

Pershkrimi	Shuma €
31121 - NDËRTESAT ARSIMORE	262,915.51
31122 - NDËRTESAT SHËNDETËSORE	426,070.64
31123 - OBJEKTET KULTURORE	217,173.70
31230 - RRUGËT LOKALE	719,881.20
32110 - SHTRITËRIT E LUMENJVE	50,000.00
34000 - PAGESAT SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE	2,220,948.28
Investime Kapitale	3,896,989.33

Tabela 7

3. Shpalosja e shpenzimeve sipas programeve/nëprogrameve në kategori ekonomike

Nr	Drejtoria	Kategoria Ekonomike	Buxheti	Realizimi	% Realizimit
1	Zyra e Kryetarit	Paga dhe Meditje	208,194.72	115,573.08	56%
		Mallra dhe Shërbime	30,000.00	11,692.03	39%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			238,194.72	127,265.11	53%
2	Auditorët e Brendshëm	Paga dhe Meditje	46,117.46	20,703.54	45%
		Mallra dhe Shërbime	18,000.00	6,494.49	36%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			64,117.46	27,198.03	42%
3	Administrata	Paga dhe Meditje	412,879.40	187,576.73	45%
		Mallra dhe Shërbime	505,442.00	183,618.45	36%
		Shpenzime Komunale	101,600.00	46,091.08	45%
		Subvencione	155,000.00	-	0%
		Investime Kapitale	57,663.04	47,323.53	82%
TOTALI			1,232,584.44	464,609.79	38%



4	Çështja Gjimore	Paga dhe Meditje	20,744.97	9,859.63	48%
		Mallra dhe Shërbime	6,500.00	-	0%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	20,000.00	-	0%
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			47,244.97	9,859.63	21%
5	Integritime Evropiane	Paga dhe Meditje	56,234.93	29,579.11	53%
		Mallra dhe Shërbime	50,000.00	4,509.40	9%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	120,000.00	22,840.00	19%
		Investime Kapitale	70,000.00	50,000.00	71%
TOTALI			296,234.93	106,928.51	36%
6	Inspeksioni	Paga dhe Meditje	180,449.75	95,749.31	53%
		Mallra dhe Shërbime	90,000.00	13,842.50	15%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			270,449.75	109,591.81	41%
7	Zyra e Kuvendit Komunal	Paga dhe Meditje	341,698.50	164,094.18	48%
		Mallra dhe Shërbime	12,000.00	2,081.09	17%
		Shpenzime Komunale		-	#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			353,698.50	166,175.27	47%
8	Financa dhe Zhvillim Ekonomik	Paga dhe Meditje	233,194.72	94,698.91	41%
		Mallra dhe Shërbime	405,010.94	261,900.14	65%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	16.09	-	0%
TOTALI			638,221.75	356,599.05	56%
9	Shërbimet e Zjarrfikësve	Paga dhe Meditje	275,057.16	122,909.59	45%
		Mallra dhe Shërbime	80,000.00	18,180.52	23%
		Shpenzime Komunale	8,000.00	2,325.93	29%
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	20,000.00	20,000.00	100%
TOTALI			383,057.16	163,416.04	43%
10	Menaxhimi Fatkeqësive Natyrore	Paga dhe Meditje	34,117.46	16,139.38	47%
		Mallra dhe Shërbime	346,798.00	111,830.27	32%
		Shpenzime Komunale		-	#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			380,915.46	127,969.65	34%



11	ZLKK	Paga dhe Meditje	52,234.93	24,429.50	47%
		Mallra dhe Shërbime	15,000.00	636.00	4%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	15,000.00	5,926.50	40%
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			82,234.93	30,992.00	38%
12	Bujqësia	Paga dhe Meditje	80,979.90	40,787.89	50%
		Mallra dhe Shërbime	20,000.00	246.10	1%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	179,773.45	2,355.45	1%
		Investime Kapitale	22.83	-	0%
TOTALI			280,776.18	43,389.44	15%
13	Pylltari dhe Inspeksion	Paga dhe Meditje	57,607.41	32,496.31	56%
		Mallra dhe Shërbime	20,000.00	10,138.30	51%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	20,000.00	20,000.00	100%
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			97,607.41	62,634.61	64%
14	Zhvillim Ekonomik	Paga dhe Meditje	99,352.39	41,304.92	42%
		Mallra dhe Shërbime	1,013,081.00	435,928.90	43%
		Shpenzime Komunale	151,000.00	63,115.13	42%
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	4,060,753.22	1,735,840.86	43%
TOTALI			5,324,186.61	2,276,189.81	43%
15	Gjeodezi dhe Kadastër	Paga dhe Meditje	137,214.83	57,450.69	42%
		Mallra dhe Shërbime	15,000.00	1,457.02	10%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			152,214.83	58,907.71	39%
16	Planifikim Hapsinor dhe Rregullativ	Paga dhe Meditje	120,842.34	65,239.29	54%
		Mallra dhe Shërbime	100,000.00	35,423.57	35%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			220,842.34	100,662.86	46%
17	Administrata Shëndetësi	Paga dhe Meditje	34,489.95	20,288.64	59%
		Mallra dhe Shërbime	100,000.00	20,451.00	20%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	80,000.00	80,000.00	100%
		Investime Kapitale	618,750.00	426,070.64	69%
TOTALI			833,239.95	546,810.28	66%



18	QKMF	Paga dhe Meditje	2,874,703.67	1,361,785.41	47%
		Mallra dhe Shërbime	808,132.00	509,932.36	63%
		Shpenzime Komunale	86,400.00	38,436.97	44%
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			3,769,235.67	1,910,154.74	51%
19	Mirëqenia Sociale	Paga dhe Meditje	199,939.70	105,462.79	53%
		Mallra dhe Shërbime	30,000.00	13,162.61	44%
		Shpenzime Komunale	5,000.00	519.79	10%
		Subvencione	400,000.00	289,143.88	72%
		Investime Kapitale		-	#DIV/0!
TOTALI			634,939.70	408,289.07	64%
20	Sherbimet Rezidenciale	Paga dhe Meditje	52,500.00	-	0%
		Mallra dhe Shërbime	45,000.00	41,872.10	93%
		Shpenzime Komunale	5,000.00	-	0%
		Subvencione	-	-	#DIV/0!
		Investime Kapitale	280,000.00	252,454.30	90%
TOTALI			382,500.00	294,326.40	77%
21	DKRS	Paga dhe Meditje	344,040.99	168,998.23	49%
		Mallra dhe Shërbime	100,007.00	59,823.40	60%
		Shpenzime Komunale	80,000.00	36,373.14	45%
		Subvencione	174,159.00	139,525.00	80%
		Investime Kapitale	290,000.00	287,173.70	99%
TOTALI			988,206.99	691,893.47	70%
22	Teatri i Qytetit	Paga dhe Meditje	218,446.24	110,812.06	51%
		Mallra dhe Shërbime			#DIV/0!
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	24,991.00	21,850.00	87%
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			243,437.24	132,662.06	54%
22	Administrata Arsim	Paga dhe Meditje	97,724.88	46,173.45	47%
		Mallra dhe Shërbime	300,000.00	69,341.00	23%
		Shpenzime Komunale	163,000.00	82,725.63	51%
		Subvencione	50,000.00	2,945.00	6%
		Investime Kapitale	2,022,000.00	998,603.50	49%
TOTALI			2,632,724.88	1,199,788.58	46%
23	Arsimi Parafillor	Paga dhe Meditje	457,879.40	176,930.18	39%
		Mallra dhe Shërbime	100,111.80	30,971.16	31%
		Shpenzime Komunale	-	-	#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	948.00	-	0%
TOTALI			558,939.20	207,901.34	37%




24	Arsimi Fillor	Paga dhe Meditje	7,488,513.19	3,660,461.01	49%
		Mallra dhe Shërbime	405,630.16	82,233.60	20%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	0.60	-	0%
TOTALI			7,894,143.95	3,742,694.61	47%
25	Arsimi Mesëm	Paga dhe Meditje	2,719,521.38	1,286,354.41	47%
		Mallra dhe Shërbime	226,438.83	54,893.08	24%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	100,597.00	79,522.80	79%
TOTALI			3,046,557.21	1,420,770.29	47%
KOMUNA E MITROVICËS		Paga dhe Meditje	16,844,680.27	8,055,858.24	48%
		Mallra dhe Shërbime	4,842,151.73	1,980,659.09	41%
		Shpenzime Komunale	600,000.00	269,587.67	45%
		Subvencione	1,238,923.45	584,585.83	47%
		Investime Kapitale	7,520,750.78	3,896,989.33	52%
TOTALI			31,046,506.23	14,787,680.16	48%

Tabela 8

Shenim: Të dhënat e prezantuara në tabelën nr.3 janë të dhëna të gjeneruara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) dhe përfshijne te gjitha Fondet Burimore te Organizatës Buxhetore **642 - Komuna e Mitrovicës**.



3.1 Paraqitja grafike e shpenzimeve të buxhetit sipas programeve/nënprogrameve buxhetore





3.2 Shpalosja e shpenzimeve në Investime Kapitale

Shenim: Të dhënat e prezantuara në tabelën nr.4 janë të dhëna të gjeneruara nga SIMFK dhe përfshijnë të gjitha Grantet Qeveritare dhe te Hyrat Vetanake sipas ndarjeve të Ligjit 08/L-332 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025 për **Komunën e Mitrovicës**.

INVESTIMET KAPITALE

	Buxheti Aktual	Shpenzimi			Index %
	A	Shpenzim i rregullt (B)	Me permbarues(C)	Totali (B+C)	
16322 ADMINISTRATA - MITROVICË	57,558.31	-	47,323.53	47,323.53	82%
53597 RREGULLIMI I OBJEKTIT TË K	50,000.00		47,323.53	47,323.53	95%
99347 PROM.QEVERIS.SE MIRE DHE FUQIZ.ROMEVE NE NIV.LOK	7,558.31			0.00	0%
16562 INTEGRIMET EVROPIANE - MITROVICË	70,000.00	-	50,000.00	50,000.00	71%
54715 HAPJA DHE MARKIMI DHE SHENJEZIMI I SHTIGJEVE TURISITIKE NE Z	20,000.00			0.00	0%
56343 Ndërtimi i shadervanit ne Liqenin Akumulues ne Mitrovicë	50,000.00		50,000.00	50,000.00	100%
18310 SHËRBIMET E ZJARRFIKËSVE - MITROVICË	20,000.00	-	20,000.00	20,000.00	100%
56357 Xhip dhe kombi bus-automjet tereni per zjarre fushore dhe ma	20,000.00		20,000.00	20,000.00	100%
48022 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - MITROVICË	4,039,000.00	769,881.20	965,959.66	1,735,840.86	43%
45797 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN KQIQ	83,000.00	66,750.00		66,750.00	80%
45866 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN LUSHTË	50,000.00		50,000.00	50,000.00	100%
45875 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN KOSHTOVE	95,000.00		47,518.86	47,518.86	50%
45889 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN VAGANICE	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100%



45897 NDERTIMI I RRUGVE NE STAN TERG	50,000.00		50,000.00	50,000.00	100%
45907 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN BAJGORE	50,000.00			0.00	0%
45909 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN VLLAHI	70,000.00		70,000.00	70,000.00	100%
45948 NDERTIMI I RRUGVE NE FSHATIN TERSTEN	30,000.00		30,000.00	30,000.00	100%
47084 NDERTIMI I RRJETIT TE UJËSJELLËSVE, STATCIONIT TË POMPIMIT,	50,000.00		27,959.62	27,959.62	56%
47210 NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN ZASELL	80,000.00		80,000.00	80,000.00	100%
47220 NDËRTIMI I RRUGËVE NË TUNELIN E PARË	80,000.00		80,000.00	80,000.00	100%
47222 NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN FRASHËR	30,000.00		30,000.00	30,000.00	100%
47234 NDËRTIMI I RRUGËS NË FSHATIN SHUPKOVC	80,000.00		69,250.91	69,250.91	87%
51930 Ndërtimi i rrugës Ali Zeneli	350,000.00	73,000.00		73,000.00	21%
51935 Ndërtimi i rrugës Lah Nimani dhe Evlia Qelebia	38,000.00	31,320.00		31,320.00	82%
51938 Rregullimi i shtratit të lumit Ibër	50,000.00	50,000.00		50,000.00	100%
51939 Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100%
52915 NDERTIMI I RRUGES CEN STAN TERGU	80,000.00			0.00	0%
52921 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN ILIRIDA	400,000.00	113,274.39		113,274.39	28%
52922 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN BAIR	450,000.00	200,000.00	47,677.66	247,677.66	55%
52923 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN SHIPOL	80,000.00	37,449.00		37,449.00	47%
52925 NDERTIMI I RRUGEVE NE FSHATIN ZHABAR	100,000.00	50,000.00	35,184.63	85,184.63	85%
52926 NDERTIMI I RRUGEVE NE FSHATIN GUSHAVC DHE VINARC	200,000.00	124,590.31		124,590.31	62%
52927 NDERTIMI I RRUGEVE NE FSHATIN BROBONIQ	30,000.00			0.00	0%
52948 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN URA E GJAKUT	50,000.00		50,000.00	50,000.00	100%



52963 ASFALTIMI I RRUGËS AGIM RAMADANI DHE BILIM BAJGORA	150,000.00			0.00	0%
53028 ZGJERIMI I RRJETIT TE KANALIZIMIT DHE PUSETAVE NË SHALE TE B	50,000.00			0.00	0%
53381 BLERJA E SEMAFOREVE, PAISJEVE SINJALIZUESE DHE NDRIQUESE NE S	186,000.00			0.00	0%
53390 ASFALLTIMI DHE RREGULLIMI I RRUGEVE NE VLLAHI, MELENICE, BAJGO	197,000.00	7,075.00		7,075.00	4%
54785 ZGJERIMI I RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK NË SHALE TE BAJGORES.	100,000.00			0.00	
54789 NDERTIMI I RRUGEVE DHE TROTUAREVE NE QYTET DHE FSHATRA (RR.	100,000.00	16,422.50		16,422.50	
54791 ASFALTIMI, RIPARIMI DHE RREGULLIMI I RRUGEVE NE QYTET DHE FS	100,000.00			0.00	
54792 NDERTIMI RREGULLIM RIPARIMI I KENDIT TE LOJRA DHE REKREACIO	30,000.00			0.00	
55187 FONDET E EFIQENCES SE ENERGIJE	30,000.00			0.00	
56290 Ndertimi i rruges Vllahi-Zhazhe	50,000.00			0.00	
56291 Ndertimi i rruges ne Rashan	50,000.00		50,000.00	50,000.00	
56292 Ndertimi i rruges ne fshatin Koprive	80,000.00		12,422.18	12,422.18	
56293 Ndertimi i rruges ne fshatin Kollovert	80,000.00		10,000.00	10,000.00	
56294 Ndertimi i rruges ne fshatin Kutllovc	30,000.00			0.00	
56295 Ndertimi i rruges ne Verrnice dhe Pirq	30,000.00		25,945.80	25,945.80	86%
73031 ADMINISTRATA - MITROVICË	618,750.00	426,070.64	-	426,070.64	69%
52950 NDËRTIMI I QKMF-SË DR. NEXHAT ÇUNI - MITROVICË	326,100.00	326,070.64		326,070.64	100%
56181 Rregullimi i oborrit te QKMF-se Dr. Nexhat Çuni	100,000.00	100,000.00		100,000.00	100%
56183 Rregullimi i AMF Fidanishte	12,650.00			0.00	0%
56187 Pajisje Mjekesore për QKMF-ne e re (Pajisje Laboratorike, S	180,000.00			0.00	0%
75607 SHERBIMET REZIDENC - MITROVICE	280,000.00	-	252,454.30	252,454.30	90%
51957 Ndërtimi i shtëpisë për personat e moshuara	230,000.00		206,890.10	206,890.10	90%
52971 NDERTIMI I SHTEPISE PER MBROJTJEN E FEMIJEVE	50,000.00		45,564.20	45,564.20	91%



85022 SHËRBIMET KULTURORE - MITROVICË	290,000.00	217,173.70	70,000.00	287,173.70	99%
52919 NDËRTIMI I BIBLIOTEKËS SË QYTETIT "LATIF BERISHA"	220,000.00	217,173.70		217,173.70	99%
52934 RREGULLIMI I OBJEKTIT TË MUZEUT TË QYTETIT	70,000.00		70,000.00	70,000.00	100%
92110 ADMINISTRATA - MITROVICË	2,022,000.00	262,915.51	735,687.99	998,603.50	49%
51970 Ndertimi i Shkollës së Muzikës	350,000.00		250,000.00	250,000.00	71%
53082 RREGULLIMI I OBJEKTIT GJIMNAZIT FRANG BARDHI DHE SHMLE HAS	600,000.00		245,687.99	245,687.99	41%
53089 NDËRTIMI I ÇERDHËS PËR FËMIJË NË FSHATIN KQIÇ I MADH	200,000.00		150,000.00	150,000.00	75%
53105 RREGULLIMI I OBJEKTIT SHFMU "MIGJENI" DHE PAISJA ME LABORAT	209,000.00			0.00	0%
53963 NDËRTIMI I QERDHE PËR FËMIJË- SHIPOL	6,000.00	5,992.50		5,992.50	100%
54474 NDËRTIMI I ÇERDHE PËR FËMIJË NË MITROVICË	300,000.00	99,999.01		99,999.01	33%
54475 NDERTIMI I ÇERDHE PËR FËMIJË NË LAGJEN URA E GJAKUT/VAGANIC	200,000.00		90,000.00	90,000.00	45%
54485 NDERTIMI I INFRASTRUKTURËS NË OBORR TË SHKOLLAVE FILLORE DHE	157,000.00	156,924.00		156,924.00	100%
93630 ARSIMI MESËM - MITROVICË	100,597.00	-	79,522.80	79,522.80	79%
53170 KABINETE PËR SHKOLLA - JUSUF REXHA, EQREM QABEJ, SHEMSI AHME	100,597.00	0.00	79,522.80	79,522.80	79%
Totali i Përgjithshëm	7,497,905.31	1,676,041.05	2,220,948.28	3,896,989.33	52%

Tabela 9



4. OBLIGIMET E PAPAGUARA (BORXHET)

Obligimet e papaguara (borxhet) deri me 30.06.2025, si organizatë buxhetore dhe atë të specifikuar në kategori ekonomike.

Kodi organizativ	Emri i Organizatës Buxhetore	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Investime Kapitale	Gjithsej
642	Komuna e Mitrovicës	-	319,309.25	-	550.00	249,133.65	568,992.90
Në përqindje (%)		0%	56%	0%	0%	44%	100%

Tabela 11

Sqarim: Në tabelën e më sipërme janë paraqitur obligimet e papaguara bazuar në rregulloren financiare nr.02/2016 të MFPT-së për raportimin e obligimeve të papaguara të Organizatave Buxhetore.

5. LËNDËT E EKZEKUTUARA NGA MINISTRIA E FINANCEVE – DEPARTAMENTI I THESARIT

Ekzekutimi i pagesave sipas procedurave përmbartimore dhe Nenit 39.2 nga Ministria e Financave - Departamenti i Thesarit deri më 30.06.2025

Kategoria Ekonomike	111	Paga dhe Shtesa	4,364.35
	130	Mallra dhe Shërbime	189,348.21
	132	Shpenzime Komunale	-
	200	Subvencione dhe Transfere	-
	300	Investime Kapitale	2,220,948.28
TOTALI			2,414,660.84

Tabela 12&13